



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 08/L-125 për Pronën Publike, Rregulloren (QRK) Nr. 04/2025 për mënyrën e mbajtjes së evidencës të së sendeve të luajtshme dhe paluajtshme dhe e regjistrimit të sendeve në pronësi publike dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E GRUPI PUNUES PËR PLOTËSIMIN E

REGJISTRIT TË PRONAVE PUBLIKE

Neni 1

Ngritet Grupi punues për verifikimin dhe plotësimin e regjistrit të pronave publike, të luajtshme dhe të paluajtshme të Komunës së Podujevës dhe atë:

Ardiana Dibrani, kryesuese

Valon Beselica, anëtar

Zanë Fazliu, anëtare

Alban Shabani, anëtar

Ardian Emimi, anëtar

Halit Vërshevc, anëtar

Neni 2

Grupi punues bën verifikimin e të dhënave të sakta, plotësimin e regjistrit të pronave publike të Komunës së Podujevës, duke përfshirë por pa u kufizuar në: tokat, ndërtesat, objektet infrastrukturore dhe asetet tjera të paluajtshme, statusin e tyre juridik, përdorimin aktual, dokumentacionin pronësor përkatës, vlerën e tyre si dhe të dhënat kadastrale në përputhje me formatin dhe udhëzimet përkatëse teknike.

Neni 3

Grupi punues për punën e kryer informon në formë të shkruar Zyrën e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Zyra e Personelit

QSHQ / Arkivi

Nr.prot. 02-020/04-0020281126

Podujevë, datë: 03.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliq





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, jep;

A U T O R I Z I M

Autorizohet z. Driton Kiçmari, ushtrues i detyrës së udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit, të deponojë nënshkrimin në Qendrën e shërbimit për qytetarë për vulosjen e gjithë dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushëveprimtarinë e Zyrës së cekur.

Autorizimi vlen për periudhën sa është i emëruar në pozitën e cekur, apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

Nënshkrimi i të autorizuarit




Nr.prot. 02-06/01-0021719/26
Podujevë, datë: 30.04.2026



Kryetari i Komunës
Shqiptim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 të datës 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione , merr:

V E N D I M **PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

Neni 1

z.Shaban Krasniqi, me numër personal të letërnjoftimit [redacted] nga fshati Breznicë, Komuna e Vushtrrisë, me rastin e sjelljes së donacionit autoambulancës nga shteti Suedez, për nevojat e QKMF-së në Podujevë, për mbulimin e shpenzimeve me rastin e transportimit të automjetit të cekur, mbështetet me mjete financiare në shumë 2500€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF

QSHQ/Arkivit.

z.Shaban Krasniqi (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-404/01-0022241/26
Podujevë, datë, 14.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 08.04.2026 të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej njëmbëdhjetëmijë e njëqind euro (11100 €) ndihmë për pesëdhjetenëntë (59) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin mars 2026, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/01-002237/26
Podujevë, datë 14.04.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe neneve 14, 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Ofertës Publike nr.prot.12-320/01-0016994/26 datë 24.03.2026 të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, Kryetari i Komunës së Podujevës, nxjerr këtë,

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim ngritet komisioni për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në menaxhim me qira të Vendgjuetisë së përbashkët "Podujeva" në territorin e Komunës së Podujevës, në përbërje:

1. **Ardian Emini**, zyrtar në kuadër të DKA, kryesues
2. **Bleona Musolli**, zyrtare në kuadër të DBPZHR, anëtare
3. **Donjeta Fazliu**, zyrtare në kuadër të DBPZHR, anëtare

Neni 2

Punët dhe detyrat e Komisionit të cekur në nenin 1 të këtij vendimi janë hapja, vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e subjekteve fizike apo juridike për dhënie në menaxhim me qira të Vendgjuetisë së përbashkët "Podujeva" në territorin e Komunës së Podujevës, duke marrë për bazë Ofertën Publike të DBPZHR, Ligjin nr.02/L-053 si dhe aktet tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Komisioni, për punët dhe detyrat e kryera sipas këtij vendimi, dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse, harton raport dhe të njëjtin ia paraqet Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-020/01-0022764/26
Podujevë, datë: 15.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisionit të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes thirrjes publike të datës 18.03.2026, nxjerr;

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-VE PËR ORGANIZMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE DHE RINORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve, për financimin publik të programeve/projekteve sipas thirrjes publike në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore të publikuar më datë 18.03.2026, themelohet komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|---------------------------|---|
| 1.Venoza Zullufi, | kryesues, zyrtare për bibliotekë – DKRS |
| 2.Blerta Ajvazi, | anëtare, zyrtare për regjistrimin e bizneseve - DPZHE |
| 3.Ardian Emini, | anëtar, zyrtar i lartë për buxhet dhe financa -DKA |
| 4.Xhevahire Gashi, | anëtare, shoqëria civile |
| 5.Ajshe Mehmeti, | anëtare, shoqëria civile |

znj.Xhyfidane Nimani, zyrtare për teknologji informative, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit - DKRS
QSHQ/Arkivit

Nr.prot, 02-020/04-0023604/26
Podujevë, datë, 20.04.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Thirrjes publike nr.prot.09-400/04-0016391/26 të datës 23.03.2026 për financimin e projekt propozimeve individuale, për organizimin e aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, ngritet Komisioni ad-hoc në këtë përbërje:

- **Blerina Fejzullahu,** kryesuese, zyrtare për rini -DKRS
- **Albert Ajvazi,** anëtar, zyrtar për për kthim- DA
- **Vjollca Islami,** anëtare, zyrtare për biblioteka - DKRS

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

*Anëtarëve të komisionit (përmes kryesuesit)
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit- DKRS
QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot.02-020/04-23602/26
Podujevë, datë, 20. 04. 2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisionit të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, përmes thirrjes publike të datës 24.03.2026, nxjerr;

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-VE PËR ORGANIZMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve, për financimin publik të programeve/projekteve sipas thirrjes publike në fushën e aktiviteteve sportive publikuar më datë 24.03.2026, themelohet komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------------|---|
| 1.Donjeta Fazliu, | kryesuese, zyrtare për bujqësi - DBPZHR |
| 2.Arben Neziri, | anëtar, zyrtar ligjor - DBF |
| 3.Vedat Muçolli, | anëtar, zyrtar për sport -DKRS |
| 4.Riad Haxha, | anëtar, shoqëria civile |
| 5.Londrim Podvorica, | anëtar, shoqëria civile |

znj.Besime Veliu, zyrtare për bibliotekë, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit -DKRS

QSHQ/Arkivit

Nr.prot, 02-020/04-0023605/26
Podujevë, datë, 20.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bufliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 17.04.2026, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NNDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0016997/24 të datës 24.03.2026, për përkrahje në projektin me fidane të Mjedrave, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- **Bleona Musolli**, zyrtare për bujqësi- DBPZHR,
- Shefrije Gashi**, zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR,
- Laureta Ajvazi**, zyrtare për bujqësi-DBPZHR

kryesuese
anëtare
anëtare

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot. 02-02/04-0023601/26
Podujevë, datë, 20.04.2026

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragraf 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së Drejtoreshës së Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave nr.prot.02-112/02-0023413/26 datë 20.04.2026, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mirsim Hodolli, zyrtar/arkëtar në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e pozitës së zyrtarit të pasurisë në Drejtorinë e cekur.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të kryerjes sa më efektive të punëve dhe detyrave të punës nga pozita e zyrtarit të pasurisë dhe i njëjti vlen deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Personelit.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari

znj. Arbnorë Uka Osmani, drejtoreshë e DBF

Zyra e Personelit

QSHQ/Arkiva

Nr.prot.02-112/02-0023797/26
Podujevë, datë: 21.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18, nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 1.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas konkursit nr.05/130 të datës 12.03.2026 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2025-2026, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

Selman Gashi , zyrtar për çështje petagogjike – Drejtorja e Arsimit	kryesues
Bahrie Talla , drejtoreshë në SHFMU “Hyzriu e Samiu” - Letanc	anëtare
Blerim Vllasa , zyrtar për arsimin e mesëm të lartë – Drejtorja e Arsimit	anëtar

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr. prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Arsimit
QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0023736/26
Podujevë, datë, 21.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 35 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët publik, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 9 të Ligjit nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët publik, si dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, dhe sipas Rekomandimit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS nr.prot.02-020/05-0024491/26 datë 24.04.2026, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E USHTRUESËS SË DETYRËS SË DREJTORIT/SHËS TË QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE-QKMF NË PODUJEVË

Neni 1

znj.Venera Muçolli, me profesion Specialiste e Mjekësisë Familjare, caktohet;

Ushtruese e Detyrës së Drejtorit/shes të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF në Podujevë.

Neni 2

E përmendura në nenin 1 të këtij Vendimi, caktohet në funksionin e cekur Ushtrues Detyre për periudhë prej gjashtë (6) muaj, dhe atë duke filluar nga data 28 prill 2026 deri më 28 tetor 2026, përveç nëse me ndonjë akt tjetër të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 3

E përmendura gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës sipas këtij Vendimi, kompensohet me pagë mujore konform Ligjit nr.08L-196 për Pagat në sektorin publik

Neni 4

Zbatimin e këtij Vendimi e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim dhe koordinim me Administratën e QKMF-së në Podujevë.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i'u dërgohet:


DSHMS-së

Administratës së QKMF-së

Të caktuarës

QSHQ / Arkivit

Nr.Prot.02-14/02-0024844/26
Podujevë, datë: 27.04.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në kërkesë nr. prot. 02-118/02-0024166/26, të datës 23.04.2026 për lirim nga pozita e Drejtorit të “SHFMU Shaban Shala” në Komunën e Podujevës, merr;

V E N D I M

Neni 1

z.Nystret Ismajli, nga Podujeva, me nr. personal [redacted] lirohet nga pozita e Drejtorit të SHFMU “Shaban Shala” në Komunën e Podujevës, i emëruar sipas vendimit nr. prot. 02-020/02-0034742/23, të datës 18.05.2023.

Neni 2

I lartcekuri sipas nenit 1 të këtij vendimi lirohet nga pozita e cekur në kërkesë të tij për arsye personale dhe familjare dhe i njëjti sipas legjislacionit në fuqi sistemohet në pozitën e mëparshme të mësimdhënësit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/02-0034742/23, i datës 18.05.2023.

U dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
z. Nystret Ismajli (Njoftohet përmes DKA)
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-118/02-0024891/26
Podujevë, datë: 28-04-2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në kërkesë nr. prot. 02-118/02-0024166/26, të datës 23.04.2026 për lirim nga pozita e Drejtorit të “SHFMU Shaban Shala” në Komunën e Podujevës, merr;

V E N D I M

Neni 1

znj.Ajshe Mehmeti, nga fshati Brainë Komuna e Podujevës, me nr. personal [redacted] lirohet nga pozita e zëvendës drejtoreshës të SHFMU “Shaban Shala” në Komunën e Podujevës, e emëruar sipas vendimit nr. prot. 02-101/03-0037728/24, të datës 10.06.2024.

Neni 2

E lartcekura sipas nenit 1 të këtij vendimi lirohet nga pozita e cekur në kërkesë të saj për arsye personale dhe familjare dhe e njëjta sipas legjislacionit në fuqi sistemohet në pozitën e mëparshme të mësimdhënësës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-101/03-0037728/24, i datës 10.06.2024.

U dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
znj.Ajshe mehmeti (Njoftohet përmes DKA)
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-118/02-0024888/26
Podujevë, datë: 28.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0019216/26 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 31 mars 2026, merr këtë,

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE - KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A.

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a, emërohet,

z. Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 01-020/04-0019216/26/25 të datës 31 mars 2026.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot. 02-020/04-0024966/26
Podujevë, datë, 12.04.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenin 61.1 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, jep këtë;

A U T O R I Z I M

I. znj.Arbenita Hoti, Inspektore e Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Podujevës, Autorizohet të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për qëllim të vulosjes së dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushëveprimin e funksionit përkatës.

II. Autorizimi vlen për periudhë të pacaktuar përderisa e përmendura është në marrëdhënie pune në këtë pozitë, apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

Nënshkrimi i të autorizuarës

Nr.Prot. 02-016/01-0025121/26
Podujevë, datë: 28.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulhiqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenin 61.1 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, jep këtë;

A U T O R I Z I M

I. znj.Leonora Fejzullahu, Inspektore e Ndërtimit në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Podujevës, Autorizohet të deponojë nënshkrimin në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, për qëllim të vulosjes së dokumentacionit që ka të bëjë me kompetencat dhe fushëveprimin e funksionit përkatës.

II. Autorizimi vlen për periudhë të pacaktuar përderisa e përmendura është në marrëdhënie pune në këtë pozitë, apo eventualisht deri në një akt tjetër administrativ.

Nënshkrimi i të autorizuarës

Nr.Prot. 02-016/01-0025116/26
Podujevë, datë: 28.04.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13, 58 shkronja (f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neni 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, dhe nenet 14, 16, 59 paragrafi 3.1 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18, sipas Kërkesës elektronike të datës 24.04.2026 për lirim nga detyra, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Neni 1

z.Gent Jetullahu, lirohet nga detyra e zyrtarit për marrëdhënie me publikun në kuadër Zyrës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, i emëruar sipas Vendimit nr.prot.02-112/02-0078128/25 të datës 03.12.2025.

Neni 2

Lirimi nga detyra e zyrtarit sipas nenit 1 të këtij Vendimi, bëhet në kërkesë të të përmendurit, për arsyeje të angazhimeve tjera nga i njëjti.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0025168/26
Podujevë, 29.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR, të datës 27.04.2026, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0019998/26, të datës 02.04.2026, për përkrahje në projektin me fidane të feferonave, somborkave dhe sistem të ujitjes, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- **Bleona Musolli**, zyrtare për bujqësi - DBPZHR, kryesuese
- **Shefrije Gashi**, zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR, anëtare
- **Laureta Ajvazi**, zyrtare për bujqësi –DBPZHR, anëtare

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot. 02-020/04-0025384/26
Podujevë, datë, 29.04.2026

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 7.2 dhe 93 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr.08/L-197, nenin 4 paragrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2018 Për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E ZYRTARIT PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN NË ZYRËN KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 1

z. Arton Rama, nga fshati Dobratin Komuna e Podujevës, me kualifikim Fakulteti Filologjik – *Dega Gazetari emërohet;*

► Zyrtar për marrëdhënie me publikun në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Podujevës

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet me qëllim të ofrimit të ndihmës teknike administrative dhe mbështetjes së Kryetarit të Komunës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi.

Neni 3

Mandati i të emëruarit është në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

Neni 4

Paga mujore e të emëruarit caktohet sipas legjislacionit në fuqi, ashtu siç kërkohet në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi dhe çështjeve tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlihen me këtë pozitë kujdeset Zyra e Personelit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0025375/26
Podujevë, datë 29.04.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buflqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale, neneve 14 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merre këtë:

V E N D I M

Neni 1

1. Autorizohen dhe njëkohësisht obligohen Inspektorët/et e Shërbimeve Publike në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës, që krahas kompetencave, detyrave dhe përgjegjësisve të tyre, të veprojnë dhe të ndërmarrin masa të nevojshme sa i përket zbatimit të Rregullores (komunale) nr.prot.01-300/01-0084080/22 për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

2. Gjithashtu Inspektorët e Tregut, të cilët janë të punësuar dhe aktualisht ushtrojnë funksionin e tyre në Komunën e Podujevës, krahas kompetencave dhe detyrave të tyre për aq sa i'u lejohe sipas legjislacionit në fuqi, dhe deri në sistemimin e tyre zyrtar dhe përfundimtar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, autorizohen dhe obligohen të ushtrojnë kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë nga fushveprimtaria e Inspektorëve të Shërbimeve Publike, përfshirë edhe zbatimin Rregullores (komunale) nr.prot.01-300/01-0084080/22 për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një akt tjetër administrativ, apo deri në rregullimin e kësaj çështje me dispozita ligjore dhe nënligjore.

I'u dërgohet:

*Drejtorisë së Inspeksionit
Inspektorëve përkatës
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot. 02-016/01-0025663/26
Podujevë, datë: 30.04.2026



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi